



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
DEPARTAMENTI I PRODHIM
MENAXHIMIT**

Sheshi “Nënë Tereza” Nr. 4 Tiranë, Shqipëri

www.fim.edu.al

Tel/fax: +355 4 2223707

Tiranë, më 04.11.2021

I. Informacion për kursin e formimit të vazhduar: “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”

Në përputhje me ligjin e ri “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 80, datë 22. 07. 2015, si dhe në mbështetje të procesit të Integrimit European, pjesë e të cilit është edhe kërkesa për krijimin e profesionit “**Vlerësues i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve**” është realizuar organizimi për herë të parë të këtij programi studimi të formimit të vazhduar për të reflektuar në të kërkesat e:

- **Ligjit Nr. 80/2015** “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, **Neni 81**: “Programet e studimeve të formimit të vazhduar”,

dhe

- në bazë të **VKM Nr. 712, datë 12. 10. 2016** “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e liçensimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”, të botuar në fletoren zyrtare numër **195 Kreu III, Neni 10** si më poshtë:

Kursi shërben për trajnimin e të gjithë personave që duan të marrin njohuri në fushën përkatëse ose/dhe të pajisen me liçencë për ushtrimin e aktivitetit të “**Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve**” në përputhje me kërkesat e **VKM nr 712 datë 12.10.2016**, Neni 14 pika 3.

II. Argumentimi për organizimin e programit të studimit të formimit të vazhdueshëm “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”

Miratimi dhe hapja për herë të parë e programit të studimit të formimit të vazhdueshëm “**Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve**” mbështetet në ligjin e ri Nr. 80, datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kursi do të zhvillohet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik, ku janë ngritur, funksionojnë dhe kanë përfunduar disa kurse trajnimi në përputhje me misionin e këtij Universiteti, si dhe nevojat e shoqërisë. Përfundimi me sukses dhe vlerësimi

pozitiv i këtyre kurseve, konform procedurave të standarteve të sigurimit të cilësisë, ka shërbyer jo vetëm për pasurimin e përvojës didaktike të stafëve të angazhuara dhe më gjerë, por edhe për forcimin e lidhjeve bashkëpunuese ndërmjet Universitetit, ndërmarrjeve industriale dhe me institucione të ndryshme.

Gjithashtu propozimi kryhet në mbështetje të procesit të Integritetit Europian dhe Direktives të Makinerive të BE 2006/42/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 17 Maj 2006 mbi makineritë dhe amendimit të Direktivës 95/16/EC. Baza ligjore e Direktivës të Makinerisë është dhënë në nenin 95 të Traktatit të KE-së që mundëson që BE të miratojë masa për të harmonizuar legjislacionin e Shteteve Anëtare për të siguruar krijimin dhe funksionimin e tregut të brendshëm. Masa të tilla duhet të marrin për bazë një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit, sigurisë së njerëzve dhe të mjedisit. Direktiva e Makinerive ka një objektivi të dyfishtë: 1. Për të lejuar lëvizjen e lirë të makinerisë në tregun e brendshëm dhe 2. Për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë.

Programi i studimeve të formimit të vazhduar: **“Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”**, realizohet për të reflektuar në të kërkesat e:

- Ligji Nr. 80, datë 22. 07. 2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*,
- Direktivës së BE 2009/127/EC: *“Direktiva e Makinerive”*
- VKM Nr. 712, datë 12.10.2016 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e liçensimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluatjshme”*.

Arsyeja kryesore për zhvillimin e këtij programi të studimit të formimit të vazhdueshëm është bazuar në faktin se aktualisht në vëndin tonë nuk janë kryer dhe organizuar kurse të njëjta ose të ngjashme për vlerësimin e këtyre pasurive specifike.

Në vëndin tonë nuk ka standarte të vlerësimit të pasurive të paluatjshme të miratuara, dhe në mungesë të tyre që prej më shumë se 20 viteve përdoren Standartet Europiane të Vlerësimit të Pasurive të hartuara dhe miratuara nga Grupi Europian i Vlerësuesve, TEGoVA. Ndërsa kemi të përkthyer në gjuhën shqipe edhe Standartet Ndërkombetare të Vlerësimit, pjesa e parë nga Kompania Deloitte Albania shpk.

Gjykojmë se është një nevojë imediate në zhvillimin e këtij kursi dhe ndërtimin e bazës për hartimin e instruksioneve dhe udhëzimeve të vlerësimit të këtyre pasurive specifike.

Programi i studimit të formimit të vazhdueshëm **“Vlerësimit të linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”** ka për qëllim të theksojë rëndësinë e kësaj shkence në vlerësimin dhe investimin e linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve. Ky program është projektuar për të rrënjosur një kuptim të plotë të të gjitha aspekteve të pasurive tekniko-mekanike, elektromekanike dhe rrjetit të infrastruktures që lidhen me to dhe në funksion të tyre. Programi kombinon ligjëratat me analiza rast pas rasti të lektorëve të mirënjohur të fushës inxhinierike dhe ekonomike si edhe diskutimin e rasteve studimore që simulojnë situata të hasura në vëndin tonë. Pjesëmarrësit kanë mundësi të njihen me përjasjen ndërkombetare dhe aplikimin e tyre në kompanitë të cilat zotërojnë pasuri

Teknike dhe Teknologjike. Në këtë program do të promovohet modeli i vlerësimit dhe investimit sipas standardeve SNV dhe SNK të cilat përdoren sot në nivel ndërkombëtar, me synimin e orientimit drejt praktikave më të mira të vlerësimit të linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve për qëllime të ndryshme.

Organizimi i programit të studimit të vazhdueshëm “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve” merr parasysh zhvillimet më të fundit në fushën e industrisë dhe nevojat e ekonomisë së vendit tonë për këtë profesion të kualifikuar.

Në këtë program studimi studentëve u sigurohet një kuptim më i mirë i llojeve të vlerës të përdorur zakonisht në vlerësimin e makinerive dhe pajisjeve. Ky program trajton çështjet e çmimit vs vlerë, shpenzimet indirekte, përdorimin dhe zhvillimin e indekseve, konceptet mosha-jetës, llojet e vlerave për vlerësimin e tyre, kostot e riprodhimit, kostoja e zëvendësimit të reja, kostoja e zëvendësimit amortizuar, vlera e drejtë e tregut në përdorim, vlera e likuidimit, vlera e detyruar likuidimi dhe konkluzionet mbështetëse për qëllime të ndryshme.

III. Objektivat e programit

Miratimi dhe hapja për herë të parë e programit të studimit të vazhdueshëm “**Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve**” mbështet në kërkesat e ligjit ekzistues “*Për Vlerësim të Pasurive të paluajtshme*”, Nr. 10, datë 12.10.2016. Programi do të zhvillohet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik, ku janë ngritur, funksionuar dhe përfunduar disa kurse trajnimi në përputhje me misionin e këtij Universiteti, si dhe nevojat e shoqërisë. Përfundimi me sukses dhe vlerësimi pozitiv i këtyre programeve, konform procedurave të standardeve të sigurimit të cilësisë, ka shërbyer jo vetëm për pasurimin e përvojës didaktike të stafëve të angazhuara dhe më gjerë, por edhe për forcimin e lidhjeve bashkëpunuese ndërmjet Universitetit dhe ndërmarrjeve e institucioneve të ndryshme.

Në vijim të kësaj përvoje shumë të vlefshme në përputhje me ligjin e ri “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 80, datë 22.07.2015, si dhe në mbështetje të procesit të Integrimit Europian, pjesë e të cilit është “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”, vjen propozimi për riorganizimin e këtij programi studimi për të reflektuar në të kërkesat e:

- Ligjit të ri “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”;
- Direktivës së BE: “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”;
- Ligjit “Vlerësimi të pasurive të paluajtshme”.

Programi do t’u shërbejë të gjithë atyre personave që kanë të paktën një diplomë universitare të nivelit “Master Shkencor” ose “Master Profesional” në Inxhinieri ose Diplomë të Fakultetit të Ekonomisë, të, përfshirë edhe ata të sistemit të vjetër në këto fusha, që duan të zhvillojnë njohuritë e tyre profesionale për të zhvilluar aktivitetin e “**Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve**”, i cili do të operojë edhe si një ekspert në vlerësimin e pasurive.

Programi “**Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve**” ka për qëllim të theksojë rëndësinë e kësaj shkence në vlerësimin dhe investimin e linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve. Ky kurs është projektuar për të rrënjësuar një kuptim të plotë të të gjitha aspekteve të pasurive Tekniko-Mekanike, Elektromekanike dhe investimeve që lidhen me to. Programi

kombinon ligjëratat me analiza rast pas rasti te lektorëve të mirënjohur të fushës inxhinjrike dhe ekonomike si edhe diskutimin e rasteve studimore që simulojnë situata të hasura në vendin tonë. Pjesëmarrësit kanë mundësi të njihen me përfaqshen ndërkombëtare dhe aplikimin e tyre në kompanitë të cilat zotërojnë pasuri Teknike dhe Teknologjike.

Në këtë program do të promovohet modeli i ri i vlerësimit dhe investimit sipas standardeve RICS të cilat përdoren sot në nivel ndërkombëtar dhe standardi i vlerësimit në nivel kombëtar, me synimin e orinetimit drejt praktikave më të mira të vlerësimit të linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve.

Riorganizimi i programit të studimit **“Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”** merr parasysh zhvillimet më të fundit në fushën e industrisë dhe nevojat e ekonomisë së vendit tonë për këtë profesion të kualifikuar.

Objektivi kryesor i këtij programi studimi është përgatitja e specialistëve të kualifikuar për kryerjen e vlerësimit të linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve në sektorin e industrisë.

Objektivi i parë i organizimit të programit është krijimi i specialistit për: Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve për t’ju përgjigjur jo vetëm teknologjive bashkëkohore, por edhe atyre për mbrojtjen e mjedisit, duke kontribuar në një zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Objektivi i dytë është krijimi i specialistit që është koherent me standartet dhe direktivat europiane të makinerive dhe pajisjeve

Objektivi i tretë është nxitja e përdorimit të makinerive dhe pajisjeve të reja.

Në fund të këtij programi të studimit të formimit të vazhdueshëm, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- 1) Njohin dhe kuptojnë se cilat janë “Linjat teknologjike, makineritë dhe pajisjet” të trupëzuara në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me tokë ose ndërtesë dhe diferencat midis tyre dhe aseteve ndërtimore.
- 2) Njohin materialet, elementët dhe projektet e skemave teknologjike si dhe specifikimet teknike të sistemeve të integruara të prodhimit, të linjave teknologjike, makinerive e pajisjeve
- 3) Njohin dhe përdorin standartet e vlerësimit për linjat teknologjike, makinerive e pajisjeve dhe aseteve të specializuara të infrastrukturës të linjave teknologjike, makinerive e pajisjeve
- 4) Kuptojnë analizën financiare të biznesit,
- 5) Njohin dhe përdorin metodat e vlerësimit dhe metodologjitë e tyre përkatëse,
- 6) Njohin dhe përdorin metodën e vlerësimit të inventarit
- 7) Përgatisin raporte vlerësimit për linja teknologjike, makineri dhe pajisjeve për qëllime të ndryshme sipas kërkesës së klientit
- 8) Njohin dhe kuptojnë Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të profesionit të vlerësuesit të pasurive.

Formimi i këtyre specialistëve, në këtë program trajnimi, i bën ata të aftë dhe u jep një kompetencë profesionale të mjaftueshme për t’u punësuar në ndërmarrje dhe institucione vendase, si dhe për të ushtruar një aktivitet të pavarur si **“Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”**.

IV. Kriteret e pranimit

Në Programin e studimit “**Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve**”, mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë:

- 1) diplomë të nivelit “Master Shkencor” ose “Master Profesional” në Inxhinieri;
- 2) diplomë sipas sistemit të vjetër të pandarë në Inxhinieri.
- 3) diplomë të nivelit “Master Shkencor” ose “Master Profesional” në Ekonomi;
- 4) diplomë sipas sistemit të vjetër të pandarë në Ekonomi.

Një kandidat, për t’u regjistruar, duhet të dorëzojë këto dokumente:

- 1) kërkesë për ndjekjen e kursit;
- 2) fotokopje të kartës së identitetit;
- 3) një CV;
- 4) fotokopje të diplomës universitare të noterizuar;
- 5) çertifikata të ndryshme të trajnimeve të kryera në këtë fushë nga institucione të akredituara;
- 6) dokumenti i pagesës së tarifës së regjistrimit.

IV.I. Procedurat e pranimit të studentëve dhe e njohjes së krediteve universitare të fituara më parë prej tyre

Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurs sipas dosjes personale të paraqitur nga secili kandidat aplikues, në pajtim me orientimet, numrin dhe kriteret e përcaktuara.

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është **1600 Lekë**. Kandidatët regjistrohen pranë Sekretarisë Mësimore të FIM, UPT, me specifikimin për drejtimin përkatës të programit:

- a) **Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve;**

Rregjistrimet në këtë program trajnimi bëhen në zbatim dhe në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe vendimet e udhëzimet e MAS dhe procedurave zyrtare të UPT. Ato kryhen pranë Sekretarisë Mësimore të FIM, UPT, dhe dosjet shqyrtohen nga Komisioni Shkencor i Programit të trajnimit për “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”, i ngritur nga Dekani i FIM.

Komisioni Shkencor shqyrton dhe miraton njohjen dhe transferimin e krediteve të fituara nga kandidatët në studime të tjera universitare.

Në këtë program trajnimi kanë të drejtë të regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj.

V. Kohëzgjatja e programit dhe struktura që e ofron

Programi i trajnimit “**Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve**”, zhvillohet me kohë të pjesshme dhe zgjat **4 muaj e gjysëm**.

Periudha e zhvillimit të këtij programi studimi parashikon:

- a) 5 module të formimit bazë;
- b) 5 module të formimit specifik – Gjithsej 10 module.

Në fund programi i studimit mbyllet me mbrojtjen e një punimi përfundimtar të pavarur të studentit (mikrotezë).

Struktura përgjegjëgjëse e programit të studimit “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve” është Departamenti i Prodhim Menaxhimit i FIM, UPT.

Programi i studimit “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve” ofrohet dhe drejtohet nga Departamenti i Prodhim Menaxhimit i FIM, në bashkëpunim me departamente të tjera të FIM të UPT-së, si dhe specialistë të fushës nga institucione të tjera.

VI. Numri i pjesëmarrësve në programin e studimit të vazhduar

Numri minimal i studentëve është 20.

VII. Frekuenca në aktivitetet e ndryshme formuese (leksione, seminare, laboratore, etj.)

Mësimi do të zhvillohet dy herë në javë:

- 4 orë mësimore ditën e premte;
- 8 orë mësimore ditën e shtunë.

Tipologjia didaktike përfshin:

- leksione
- ushtrime/seminare
- punë praktike
- konsultime me studentin.

Frekuenca në aktivitetet didaktike duhet të jetë jo më pak se 75% pjesëmarrje në auditor për çdo kandidat, me përjashtim të punëve praktike/laboratorike ku kërkohet 100%.

Koordinator i Programit do të jetë Prof. Asoc. Jonida TETA (email: jteta@fim.edu.al).

IX. Tarifa për çdo student, mënyra dhe afatet e pagesës së saj

Tarifa e shkollimit për çdo student është:

- a) Për kursin “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”: **130,000 Lekë.**

Kjo tarifë mund të paguhet edhe në dy pjesë (dy këste).

Në përfundim të kursit, çdo person që e finalizon me sukses duhet të bëjë një pagesë **500 Lekë** për certifikatën e kursit përkatës dhe listën e notave.